

## Trajnime të OSBE-së për Lidërsip Rinor 2.0

### Datat e aktiviteteve:

- **Trajnimi i parë:** 19 – 22 gusht 2024
- **Trajnimi i dytë:** 2 – 5 shtator 2024

### Afati i aplikimit:

- **Trajnimi i parë:** 12 gusht 2024
- **Trajnimi i dytë:** 23 gusht 2024

### Rreth projektit:

Misioni i OSBE-së në Shkup së bashku me Qendrën për Dialog Interkulturor Kumanovë (CID Kumanovë) do të organizojnë dy trajnime dinamike për Lidërsip Rinor që synojnë inkurajimin e udhëheqje, përvetësimin e aftësive dhe promovimin e angazhimit qytetar mes të rinjve. Trajnimet do të mbahen vende piktoreske në natyrë, ku pjesëmarrësit do të mund të shijojnë një mjedis frymëzues duke zhvilluar aftësitë e tyre.

Çdo trajnim do të zgjasë katër ditë dhe do të mirëpresë 20 pjesëmarrës nga të gjitha rajonet e Maqedonisë së Veriut. Programi i trajnimit do të përfshijë punëtori interaktive, detyra ekipore, debate, lojëra simuluese dhe aktivitete të tjera që do ti ndihmojnë të rinjtë të zhvillojnë aftësitë e tyre në udhëheqje dhe komunikim.

### Temat që do të trajtohen:

- ***Inkurajimi i pjesëmarrjes së të rinjve në shoqëri dhe në proceset shoqërore:*** Pjesëmarrësit do të mësojnë se si të bëhen qytetarë aktivë dhe të ndikojnë në ndryshimet sociale. Do të zhvillohen ushtrime praktike dhe diskutime mbi rolin e të rinjve në komunitet.
- ***Njohja e të rinjve me demokracinë dhe pjesëmarrjen demokratike:*** Do të diskutohen parimet e demokracisë dhe kuptimi i pjesëmarrjes në proceset demokratike.
- ***Aktivizmi rinor dhe udhëheqja:*** Do të promovohen forma të ndryshme të aktivizmit rinor dhe mënyra se si të rinjtë mund të përfshihen në ndryshime pozitive. Pjesëmarrësit do të kenë mundësinë të dëgjojnë nga aktivistë të rinj të suksesshëm dhe të mësojnë nga përvojat e tyre.

- **Pjesëmarrja Rinore:** Do të diskutohen mundësi dhe platforma të ndryshme për pjesëmarrjen rinore në nivel lokal dhe kombëtar. Do të organizohen punëtori për shkrimin e projekteve dhe aplikimin për grante.

### **Qëllimet e trajnimeve:**

**Zhvillimi i aftësive udhëheqëse dhe të punës në grup:** Përmes aktiviteteve të ndryshme, pjesëmarrësit do të përmirësojnë aftësitë e tyre udhëheqëse dhe do të mësojnë se si të punojnë në mënyrë efektive në një ekip. Trajnimi do të mbahet për aftësitë e komunikimit, zgjidhjen e konflikteve dhe aftësitë organizative.

**Përfshirja e të rinjve në aktivitete qytetare dhe promovimi i qytetarizmit aktiv:** Inkurajimi i të rinjve që të përfshihen në aktivitete qytetare dhe të bëhen pjesëmarrës aktivë në komunitet. Do të organizohen veprime për të mbështetur komunitetet lokale dhe aktivitetet vullnetare.

**Krijimi i një rrjeti të qëndrueshëm të liderëve të rinj:** Pjesëmarrësit do të kenë mundësinë të ndërtojnë një rrjet kontaktesh dhe miqësish me liderë të tjerë të rinj nga pjesë të ndryshme të vendit. Do të organizohen aktivitete vijuese dhe platforma online për komunikim dhe bashkëpunim.

### **Shënim:**

Gjatë aplikimit, aplikantët duhet të tregojnë nëse do të marrin pjesë në trajnimin e parë apo të dytë. Gjithashtu është e detyrueshme që pjesëmarrësit nga të dy aktivitetet të marrin pjesë në aktivitetet që do të zhvillohen pas trajnimeve. Këto aktivitete do të përfshijnë punëtori vijuese, takime online dhe forma të tjera bashkëpunimi për të siguruar zhvillimin e vazhdueshëm dhe rrjetëzimin e pjesëmarrësve.

Një deklaratë e pajtimit nga prindi/kujdestari është e detyrueshme për pjesëmarrësit nën moshën 18 vjeç.

### **Profili i pjesëmarrësve:**

- **Mosha:** 15-29 vjeç
- **Pjesëmarrja:** Pjesëmarrja në të gjitha aktivitetet është e detyrueshme
- **Interesi:** Të tregohet interes dhe përkushtim për të marrë pjesë në një nga dy aktivitetet

### **Akomodimi dhe logjistika:**

Të gjitha shpenzimet në lidhje me akomodimin, udhëtimin, materialet e trajnimit, ushqimin dhe pijet freskuese do të mbulohen nga Misioni i OSBE-së në Shkup.